

Pjesëmarrja në forumin "Të punojmë së bashku" organizuar nga EUROSAT dhe ECIA

Në datën 2 tetor 2023, në Bruksel u mbajt forumi "Të punojmë së bashku" organizuar nga EUROSAT dhe ECIA.

Fjalën e hapjes së këtij forumi e mbajti z. Miloslav Kala, President i EUROSAT dhe President i Zyrës së Auditimit Suprem të Republikës Çeke, shoqëruar nga z. John Bendermacher, President i ECIA. Në këtë forum të ftuar ishin presidentet e SAI-ve të Letonisë, Portugalisë dhe Maltës. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, z. Qeram Cibaku dhe Përgjegjësjë e Sektorit të Komunikimit dhe Botimeve, znj. Amantja Patozi.



Panelet e diskutimit u fokusuan në bashkëpunimin midis auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, bashkëpunim i cili ka një objektivi të përbashkët, përkatësisht përmirësimin e vazhdueshëm të qeverisjes së mirë brenda sektorit publik duke sjellë rritjen e efikasitetit dhe shmangien e dyfishimit të punës. Drejtuesit e SAI-ve pjesëmarrëse gjatë ndërhyrjes së tyre në panelet e diskutimit iu referuan rasteve të ndryshme të praktikës së mirë, duke u fokusuar në bashkëpunimin e shkëlqyer mes SAI-it dhe zyrave të auditimit të brendshëm.

Në fillimet e tij bashkëpunimi ndërmjet auditimit të jashtëm dhe të brendshëm në sektorin publik është parë me një shkallë të konsiderueshme skepticizmi, por sot kemi zhvillimin e një progresi të konsiderueshëm në këtë fushë.